



MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 196 Prot.

Tiranë, më 17.032015

VENDIM Nr. 24, datë 11.03.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, të datës 11.03.2015, pasi shqyrtoi "Relacionin për verifikimin në terren, të gjurmëve të një dyshemeje me mozaik dhe rrënojave të një kishe, fshati Sherisht, komuna Qëndër-Vlorë", realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

- I. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës, të evidentojnë dhe paraqesin një propozim për shpalljen zonë e mbrojtur arkeologjike, zonën ku janë gjetur gjurmët e një dyshemeje me mozaik dhe rrënojat e një kishe, në fshatin Sherisht, komuna Qëndër-Vlorë", dhe përreth saj, e cila është e pasur me potencial arkeologjik.
- II. DRKK-Vlorë të kryejë punimet për mbulimin e mozaikut, me qëllim mosdëmtimin e mëtejshëm të tij.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: www.asha.gov.al